

Përmbledhje e rregullave më të rëndësishme lidhur me Virusin Corona (SARS-CoV-2)

1. **Sa më pak kontakte me njerëz të tjerë** (përveç familjes / të afërmve në shtëpi).
2. Kontaktet jashtë apartamentit lejohen vetëm nëse respektohen këto rregulla:
 - a. Jashtë ambienteve shtëpiake duhet të mbani një **distancë minimale prej 1.5 metrash nga njerëzit e tjerë**. Kjo vlen gjithashtu edhe për aktivitetet sportive në natyrë (por jo për personat që jetojnë në një apartament të përbashkët). Ndalohet mbledhja në **grupe, piknike dhe për zgarë** në ambiente publike.
 - b. Individëve u lejohe të qëndrojnë në hapësira publike. **Në hapësirat publike lejohet të qëndrojnë bashkë maksimalisht dy persona** (ky rregull nuk vlen për personat që jetojnë në një apartament të përbashkët).
3. Lejohen aktivitetet e nevojshme, siç janë
 - aktivitete fizike dhe sportive në natyrë,
 - vizita urgjente te mjeku
 - Vizitat në farmaci dhe dyqane për kozmetikë
 - Furnizimi me ushqime, mallra dhe shërbime për nevoja ditore:
 - supermarkete
 - dyqanet e pijeve
 - bankat, bankat e kursimeve
 - Pikat e karburanteve

4. Të gjitha shërbimet dhe aktivitetet që nuk janë absolutisht të domosdoshme dhe ku nuk mund të respektohet distanca minimale prej 1.5 metrash nga personi tek personi janë të ndaluara. Kjo vlen veçanërisht për:

- Parukierëtë
- Studiot e tatuazheve
- Sallonet për rregullimin e thonjve
- Sallonet kozmetike

5. Gjatë ditëve të tregut javor jelohe vetëm shtande për gjëra ushqimore.

Me rëndësi: distanca minimale prej 1.5 metrash ndërmjet klientëve.

6. Dyqanet e materialeve ndërtimore dhe të veglave janë të mbyllura për klientët privatë.

7. Sheshet e lojërave nuk mund të përdoren.

→ Të gjitha rregullat vlejné fillimisht deri më 18.04.2020. Një vazhdim i tyre është i mundur.

→ Mund të shpallen edhe ndalime të tjera për vende të caktuara publike.

→ Shkeljet përbëjnë kundërvajtje administrative në bazë të Ligjit për mbrojtjen nga Infeksionet dhe dënohen me **gjobë deri në 25,000 Euro.**

→ **Policia kontrollon respektimin e këtyre rregullava.**

Dekreti i përgjithshëm zyrtar dhe i plotë i Ministrisë së Shëndetësisë së Saksonisë së Ulët për kufizimin e kontakteve sociale nga 22 Mars 2020 është në dispozicion për t'u shkarkuar këtu:

www.niedersachsen.de/Coronavirus/erlasse-und-allgemeinverfuegung